

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 790 Prot.

Tiranë, më 26.11 2015

**VENDIM Nr. 121, datë 18.11.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "**Për Trashëgiminë Kulturore**" (i **ndryshuar**), **Neni 47**, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.14, të datës 18.11.2015, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren të gjendjes faktike, **në kuadër të Projektit "Bypass"-Vlorë, Autoriteti Rrugor Shqiptar**, realizuar nga specialistë të ASHA në bashkëpunim me specialistë të DRKK Vlorë, pas informacionit të përcjellë nga kjo drejtori (Shkresa Nr. 211 Prot., datë 28.07.2015), për fillimin e punimeve në disa segmente të Bypass-it Vlorë,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren të gjendjes faktike, **në kuadër të Projektit "Bypass" - Vlorë, Autoriteti Rrugor Shqiptar**, realizuar nga specialistë të ASHA në bashkëpunim me specialistë të DRKK Vlorë, pas informacionit të përcjellë nga kjo drejtori (Shkresa Nr. 211 Prot., datë 28.07.2015), për fillimin e punimeve në disa segmente të Bypass-it Vlorë.
- II. Të realizohen nga shoqëri e licencuar në arkeologji, sondazhe arkeologjike në pjesën e gjurmës së rrugës, ku janë identifikuar tre pika me gjetje arkeologjike sipërfaqësore midis KM:25+000 deri në KM:26+500 (në hyrje të fshatit Tragjas i Ri), duke lidhur më parë kontratë tre palëshe ndërmjet investitorit, shoqërisë së licencuar në arkeologji dhe ASHA. Raporti i tyre të paraqitet në KKA e radhës.
- III. Të realizohet nga shoqëri e licencuar në arkeologji, ndjekja e vazhdueshme e zbatimit të punimeve pranë fshatit Kaninë, nga KM:10+420 (në hyrje të fshatit Kaninë) deri në KM 12+100, duke patur parasysh distancën e afërt nga Kalaja e Kaninës dhe Varrezat Antike, duke lidhur më parë kontratë tre palëshe ndërmjet investitorit, shoqërisë së licencuar në arkeologji dhe ASHA.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)